

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kur Arteta ishte duke 'u bërë' anglez: Gati të hyja në luftë me FIFA
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/26/kur-arteta-ishte-duke-u-bere-anglez-gati-te-hyja-ne-luft-me-fifa/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 11:43:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	26 shtator 2026, 11:35:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 26 shtator 2026, 11:34:00 UTC → 26 shtator 2026, 11:36:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ab6f53bcb691146650fa918fa564bd2e7cb6759d8dadaeafd2f7990f9f201361
TEKSTI	4230986f0128e56d2a1ec0224d72a5aaa4b97dd0effb9c9973b80f33e28d5bcc
PAMJA	7073971c1e3d281c4fb3ea56a0a7b782d304996ccf2aa042f5ac0996754e2a63

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	129ccf2fe0fa7e8dc891e358d9694af48569d9946e1b0051094bc7c88497a27c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	0248b36ffa7147e2cf97c5d4334b4ac10f1e643fb19828b3303283d4e0ef69ec
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/129ccf2fe0fa7e8dc891e358d9694af48569d9946e1b0051094bc7c88497a27c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FUTBOLL KURIOZITETE - SPORT SPORT TË FUNDIT

Kur Arteta ishte duke 'u bërë' anglez: Gati të hyja në luftë me FIFA

26/09/2026 13:35



Futbollist profesionist që në moshën 18 vjeçare ku shkëmbeu akademinë e Barcelonës me atë të Paris Saint Germain, Mikel Arteta kaloi pjesën më të madhe të karrierës së tij në Angli. Për 12 vjet, mesfushori spanjoll është aktivizuar në radhët e Everton dhe Arsenalit deri në vitin 2016 kur vari këpucët në gozhdë. Më pas ai vijoi karrierën si trajner duke u shndërruar në një prej më të suksesshmit me kulmin që e arriti sezonin e kaluar kur drejtoi Arsenalin të fitonte titullin që i mungonte prej 22 vitesh dhe të arrinte në finalen e Champions Leagues pas 20 vitesh.

Por në gusht të 2010, pas titullit botëror të fituar nga Spanja në Afrikën e Jugut, Arteta ishte një prej mesfushorëve që Fabio Capello, trajneri i Anglisë i asaj kohe dhe Federata Angleze menduan ta grumbullonin. Mikel Arteta nuk kishte luajtur asnjë minutë për kombëtaren e madhe të Spanjës, por ishte aktivizuar me ekipet e moshave të La Roja. Në atë kohë FIFA kishte një rregullore krejt tjetër në lidhje me zgjedhjet e futbollistëve për kombëtarët.

Vite më pas, Arteta në një intervistë për Talksport pranoi se u tundua nga ideja që të luante me kombëtaren angleze dhe ishte gati të hynte në një betejë ligjore për ta arritur një gjë të tillë. *'Më telefonuan. Fabio Capello hyri në kontakt me David Moyes kur unë isha te Everton dhe fola me ta-tregon Arteta-po e konsideroja seriozisht të luaja për Anglinë, por në atë kohë ekzistonte një normë e UEFA apo FIFA që nuk e lejonte. Do të na duhej të shkonim në gjyq dhe ishte një rrëmujë e madhe. Isha gati të hyja në luftë, por në fund vendosëm se të sfidoje FIFA ishte diçka e madhe. Për më tepër, objektivi im gjithnjë ka qenë të luaja me kombëtaren spanjolle. Në ato momente kisha ende shpresa për një telefonatë'.*

Idenë për të luajtur me kombëtaren angleze Arteta e konfirmoi edhe në një intervistë tjetër, për 'The Independent'.

'Po të ishte ndonjë kombëtare tjetër do të kisha thënë jo. Por unë kam kaluar pjesën më të madhe të karrierës në Angli, është shtëpia ime e dytë. Familja ime është këtu, kam gjithçka. Kështu që e mora me të vërtetë në konsideratë këtë ide-ishin fjalët e Artetës.

Mesfushor elegant dhe me shumë cilësi organizative, Arteta nuk mundi të luante me La Roja dhe kjo kishte logjikën e saj; ai rastisi në me kampionët e parë të botës në një prej mesfushave më të mira në historinë e futbollit; Xabi Alonso, Busquets, Xavi, Iniesta, Cesc Fabregas, David Silva...

'Ka pasur 3 raste që mendova se isha shumë pranë grumbullimit dhe në dy prej tyre isha i dëmtuar teksa nga kombëtarja e Spanjës më vinin mesazhe që më uronin shërim të shpejtë duke më thënë se isha shumë pranë bashkimit me ta-tregon Arteta vite më pas me një ton disi dorëzimi-do të më pëlqente të isha i grumbulluar te Spanja, por e kuptoj

SPORT • KRYESORE



Analiza/ Endi Tufa: Sonte nuk luajnë vetëm 11-të, sonte luajmë të gjithë



Maran ndez debutimin: Më emocionon Shqipëria, më bën krenar, duhet të jemi të vendosur për rezultatin



Frikë për ish futbollistin e Juventusit, operohet me urgjencë në mushkëri, është në terapi intensive



Fusha kthehet në ring! Lukaku bën gjestin e turpshëm ndaj italianëve, Donnarumma humb toruan dhe vërsulet drejt tij



Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb

ME TË LEXUARAT

Fusha kthehet në ring! Lukaku bën gjestin e turpshëm ndaj italianëve, Donnarumma humb toruan dhe vërsulet drejt tij

'Thuajse e humbëm ndeshjen për fajin tënd' / Xavi Hernandez vlerëson

shumë mirë sepse kjo nuk ndodhi. Kishte një mestushë fantastike, ndoshta më e mira e çdo brezi. E pranoj se ishin më të mirë se unë, kaq e thjeshtë është'.

Në 2024, për The Athletic, Mikel Arteta foli sërish për mundësinë e grumbullimit me Anglinë edhe për shkak të konkurrencës të La Roja. 'Po, do ta kisha bërë. Ndihej krenar për këtë. Edhe isha shumë realist, duke parë lojtarët që ishin të Spanja në atë moment dhe sfida e madhe që do të ishte. është e nevojshme të pranosh nivelin tënd dhe kjo është shumë e rëndësishme-ishtin fjalët e Artetës..

Top Channel

I Futboll »



Festa e Lionel Messit kthehet në çështje të Roma, Dybala e Molina marrin ftesën, por klubi 'ngre murin'

26/09 12:49



Manchester City fajtor, çfarë rrezikon klubi anglez. A do ta humbasë Champions League e 2023? Nëntë pyetjet për të kuptuar superprocesin në Premier League

26/09 12:14



Analiza/ Endi Tufa: Sonte nuk luajnë vetëm 11-të, sonte luajmë të gjithë

26/09 11:18



Frikë për ish futbollistin e Juventusit, operohet me urgjencë në mushkëri, është në terapi intensive

26/09 11:14



Shtohen telashet për Granit Xhakës, dyshohet se përdori certifikaten e falsifikuar të vaksinimit në SHBA

26/09 10:47



Mancini-Italia, nuk është më viti 2018, e dhëna që tremb dhe aspekti psikologjik që nuk duhet nënvlerësuar

26/09 10:16

ne maksimum portierin e Gjermanisë

Miq të bëjnë ligjin në Europë, Belgjika "shuan" Italinë, fitore minimale për Francën e Ukrainën

'Gjërat nuk janë mirë, besoj se do të kthehet në shtëpi' / Zidane e parandjeu, Federata Franceze konfirmon kthimin e Mbappe në Madrid

Manchester City fajtor, çfarë rrezikon klubi anglez. A do ta humbasë Champions League e 2023? Nëntë pyetjet për të kuptuar superprocesin në Premier League

Analiza/ Endi Tufa: Sonte nuk luajnë vetëm 11-të, sonte luajmë të gjithë

E nisi me gol, e mbylli i dëmtuar, alarm për Mbappë pas debutimit të Zidane

Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, policia njofton masat që do merren për garantimin e sigurisë gjatë saj

Epoka Zidane nis me fitore, Mbappë godet dhe Franca merr tri pikët

Zhënjim në debutim, Italia mposhtet 0-2 nga Belgjika, Van Bommel e nis me buzëqeshje

I Kuriozitete - Sport »



Ronaldo me zemër të artë, bllokoi pagën e tij për të shlyer detyrimet e klubit ndaj shokëve të tij të skuadrës

25/09 13:47



Izraeli, lojtari shënon dhe simulon gjuajtje bilardoje me flamurin e këndit, arbitri e përjashton(VIDEO)

25/09 10:52



Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar! / Roberto Carlos trondit botën e futbollit: Humba 99% të pasurisë brenda një nate

25/09 00:40



Drama jo më sekrete e Andy Carroll: Më kanë sulmuar seksualisht

24/09 20:34



Si ndryshojnë planet ndaj Bjellorusisë? Asllani e Cake me probleme fizike, Maran kërkon zgjidhje në stërvitje

24/09 19:52




8 vite më pas, asgjë nuk ka ndryshuar, prapaskanat e debutimit të dytë të Mancinit me "Axurrët"

24/09 19:46

I Sport »





Festa e Lionel Messit kthehet në çështje të Roma, Dybala e Molina marrin ftesën, por klubi 'ngre murin'

26/09 12:49



Manchester City fajtor, çfarë rrezikon klubi anglez. A do ta humbasë Champions League e 2023? Nëntë pyetjet për të kuptuar superprocesin në Premier League

26/09 12:14



Analiza/ Endi Tufa: Sonte nuk luajnë vetëm 11-të, sonte luajmë të gjithë

26/09 11:18



Frikë për ish futbollistit e Juventusit, operohet me urgjencë në mushkëri, është në terapi intensive

26/09 11:14



Shtohen telashet për Granit Xhakës, dyshohet se përdori certifikaten e falsifikuar të vaksinimit në SHBA

26/09 10:47



Mancini-Italia, nuk është më viti 2018, e dhëna që tremb dhe aspekti psikologjik që nuk duhet nënvlerësuar

26/09 10:16

Na ndiqni:




I Video »



Top News- TikTok paguan 100 milionë dollarë dhe kufizon përdorimin për fëmijët në Alabama



Top News – Shembja e godinës në Athinë/ Tre shqiptarë mes viktimitave, trupat ende nën rrënoja



Top News- Irani i ofron marrëveshje SHBA-së, gati për të rihapur Ngushticën e Hormuzit



Top News- 'Bora e përjetshme' drejt zhdukjes, çfarë po ndodh me Malet Paupas, klima po "vdes"



Top Channel/ Papa në Paris jep alarmin: Të mbrojmë jetën njerëzore, kujdes me AI-n!



Top Channel/ Aksident në Thumanë, tre mjete përplasen me njëra-tjetrën, humb jetën një 19-vjeçar

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Përputhen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.